



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë C (4)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 40 seminare

Viti / Semestri : Viti II , Semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor pranë Departamenteve të tjera FGJH

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Moduli përcjell tek studentët aftësinë e të qenit kreativë, duke debatuar, mbështetur dhe arsyetuar në mënyrë kritike dhe autokritike në gjuhën italiane, ky nivel përcjell informacion të larmishëm në auditor, i cili shpesh kapërcen dhe tipologjinë tematike të metodës në fjalë; aftësia për të vlerësuar dhe vetvlerësuar, bashkshoqëron dhe aftësinë për të rrëfyer ndodhi të së shkuarës, për të konsultuar informacione të ndryshme në faqe web, apo njoftime nëpër gazeta e revista duke zgjeruar kështu linjën e njohurive dhe angazhimeve akademike përmes gjuhës së huaj të dytë; në fund, lënda përcjell mesazhin e familjarizimit dhe përdorimit të teknikave e dimensioneve gjuhësore në procesin e të mësuarit dhe të të nxënit.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të ndihmojë studentin në një komunikim të rrjedhshëm nëpërmjet trajtimit të temave të ndryshme dhe të larmishme.
2. Të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha konceptet themelore dhe strukturat gjuhësore morfologjike të gjuhës italiane, të tilla si sistemin emëror dhe foljor, përemrat, ndajfoljet dhe grupimet e tyre, pjesët e ndryshme të ligjëratës, formimi i periudhave dhe analiza e detajuar e tyre.

Rezultate të pritshme:

Në fund të këtij kursi studenti do të jetë i aftë të kryej një komunikim të rrjedhshëm, të pasurojë fjalorin e tij dhe të shkëputet gradualisht nga tekstet duke dhënë edhe vetë mendime mbi çështje të ndryshme. Gjithashtu studenti do të jetë i aftë të identifikojë dhe veçojë konceptet dhe format themelore të strukturave gjuhësore morfologjike; të identifikojë dhe të veçojë të gjitha format themelore të shtjelluara dhe të pashtjelluara; të realizojë analizë morfologjike të fjalës